



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:914796

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06087751

C.nr.320/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Zenel Tasholli, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit F.T., nga fsh. i Ri, K. L., të cilin e përfaqëson av. Sabri Kryeziu me seli në Lipjan, kundër të paditurës International M. H.tani Millennium Hospital Sh.P.K. me seli në fsh. Preoc, K. Graçanicë, për shpërblim dëmi, jashtë seance, më datë 27.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se padia e paditësit Fehmi Troshupa, nga fsh. R. i R., K. L.. kundër të paditurës I.M.. H., tani M.. H..Sh.P.K. me seli në fsh. P., K. .., në këtë çështje kontestimore – për shpërblim dëmi, është **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi F.... nga fsh. R.. i R., K. L., përmes të autorizuarit të tij me dt. 27.08.2018, ka parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës I.. M..H., tani M.. H..Sh.P.K. me seli në fsh. P., K. G., për shpërblim dëmi.

Me dt. 13.06.2024, gjykata i ka kthyer palës paditëse padinë në plotësim, e për qka pala ka pasur afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Me nenin 102, par. 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.”*

Duke marr parasysh faktin se aktvendimin C.nr.320/18, të dt. 13.06.2024, me të cilin pala paditëse është obliguar që ta plotësoj padinë, i autorizuari i paditësit e ka pranuar më dt. 26.06.2024, aktvendim konform të cilit pala nuk ka vepruar dhe padinë e parashtruar nuk e ka plotësuar, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, e këtë duke u bazuar në nenin 102 par. 3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.320/18, datë: 27.08.2024

Gj y q t a r i
Zenel Tasholli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.